



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 30.03.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 23.03.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik N.T.P ERAMED lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje për laboratorët mikrobiologjik në IKSHPK” me numër prokurimi: 206-23-651-1-1-1 nxjerr:

V E N D I M

1. **Aprovohet** si e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik N.T.P ERAMED të dt. 15.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me pajisje për laboratorët mikrobiologjik në IKSHPK” me numër prokurimi: 206-23-651-1-1-1, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës 15.02.2023 të publikuar në platformën elektronike.
2. **Hiqet** kriteri nr. 6 i Përshtatshmërisë profesionale në NJK dhe DT (nuk kërkohej certifikata ISO 13485);
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik N.T.P ERAMED me datë 23.03.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: ““Furnizim me pajisje për laboratorët mikrobiologjik në IKSHPK” me numër prokurimi: 206-23-651-1-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 30.03.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkëlur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE N.T.P ERAMED:

- Nenin 1 - Qëllimi
- Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Nenin 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Pretendimi ankimor

Pasi qe pranuar vendimin për rishqyrtim te kërkesës sonë dhe vendimit tuaj qe Certifikata ISO 13485 e prodhuesit me validitet te kerkohet per LOT 2, 3 dhe 4 dhe mos te kerkohet per LOT 1, ne "ERAMED" bëjmë prap kërkesë për rishqyrtim qe te pranohet kërkesa jone qe certifikata ISO 13485 te kërkohe vetëm për produktet për te cilat është i aplikueshëm ky standard perfshire edhe produktet nga LOT 2 dhe 3 qe janë subjekt i aktivitetit te prokurimit me titull: Furnizim me pajisje për laboratorët mikrobiologjik në IKSHPK dhe me numër te prokurimit: 206-23-651-1-1-1 .

Ne këtë aktivitet te prokurimit ka pajisje qe nuk prodhohen dhe nuk klasifikohen sipas ISO 13485 si psh artikujt me poshtë:

LOT 2

Art. 3 - Incubator - Ky artikull prodhohet sipas standardeve EN 61010 dhe EN 60529 - Standarde Europiane qe specifikon kriteret për inkubator, siguria e matjes se temperatures, kontrolla dhe perdorimi laboratorik.

Art. 4 - Cooled incubator - Ky artikull prodhohet sipas standardeve EN 61010 dhe EN 60529 - Standarde Europiane qe specifikon kriteret per inkubator, siguria e matjes se temperatures, kontrolla dhe perdorimi laboratorik.

Art. 5 - Sterilizater - Ky artikull prodhohet sipas standardeve EN 61010 dhe EN 60529 - Standarde Europiane qe specifikon kriteret per sterilizator, siguria e matjes se temperatures, kontrolla dhe perdorimi laboratorik.

Art. 7 - Hot plate stirrer - Ky artikull prodhohet sipas standardeve EN 61010 dhe EN 61326 - Standarde Europiane qe specifikon kriteret per resho me perzires, siguria e matjes se temperatures, kontrolla dhe perdorimi laboratorik.

Art. 8 - Tube rotator - Ky artikull prodhohet sipas standardeve EN 61010, EN 61326 dhe EN 63000 - Standarde Europiane qe specifikon kriteret per rotator, siguria e matjes se temperatures, kontrolla, perdorimi laboratorik dhe përputhshmëria elektromagnetike.

Art. 9 - Shaker 3D - Ky artikull prodhohet sipas standardeve EN 61010, EN 61326, EN 63000 dhe EN 45501 - Standarde Europiane qe specifikon kriteret për Shakerit, siguria e matjes se temperaturës, kontrolla dhe perdorimi laboratorik.

Art. 10 - Electronic Balance - Ky artikull prodhohet sipas standardeve EN 61010, EN 61326 dhe EN 63000 - Standarde Europiane qe specifikon kriteret per peshore, siguria e matjes se temperatures, kontrolla dhe perdorimi laboratorik.

Si prodhues i BE-se ne rast se do te ishte kusht qe pajisja te jete konform standadid ISO 13485 prodhuesi do te detyrohej te certifikoj pajisjen edhe me kete standard.

Psh. per Art. 1 nga LOT 2 aplikohet Certifikaten ISO 13485. Ne kete aktivitet te prokurimit ka pajisje qe nuk prodhohen dhe nuk klasifikohen sipas ISO 13485 si psh artikujt me poshte:

LOT 3

Art. 1 - Laboratory Refrigerator/frezer - Ky artikull prodhohet sipas standardeve EN 61010 dhe EN 61326 - Standarde Europiane qe specifikon kriteret per frigorifer/friz, siguria e matjes se temperatures, kontrolla dhe perdorimi laboratorik.

Art. 2 - Laboratory refrigerator; 400 L - Ky artikull prodhohet sipas standardeve EN 61010 dhe EN 60529 - Standarde Europiane qe specifikon kriteret per frigorifer, siguria e matjes se temperatures, kontrolla dhe perdorimi laboratorik.

Art. 3 - Laboratory freezer - Ky artikull prodhohet sipas standardeve EN 61010 dhe EN 60529 - Standarde Europiane qe specifikon kriteret per friz, siguria e matjes se temperatures, kontrolla dhe perdorimi laboratorik.

Si prodhues i BE-se ne rast se do te ishte kusht qe pajisja te jete konform standadid ISO 13485 prodhuesi do te detyrohej te certifikoj pajisjen edhe me kete standard.

Autoriteti Kontraktues mund te shkaktoj eliminim jo thjesht konkurencen, por edhe qellimin ligjor per te cilin zhvillohet ky aktivitet i prokurimit duke kufizuar pjesemarrjen me te gjere te OE e cila eshte ne kundershtrim me Ligjin e Prokurimit.

Bazuar ne kete fakt ne bejme prap bere kerkese qe te kerkohet certifikata ISO 13485 vetem tek produktet ku eshte i aplikueshem ky standard.

Andaj, nga ato qe u ceken me larte dhe bazen ligjore lidhur me kete procedure tenderuese kerkojme qe te pranohet kerkesa jone nga ana e AK-se qe certifikata ISO 13485 te kerkohet vetem per produktet per te cilat eshte i aplikueshem ky standard dhe te na mundesohet te ushtrojme te drejten tone per pjesemarrje si OE.

Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore

MSh e ka shqyrtuar Kërkesën tuaj te pare për rishqyrtim te datës 15.03.2023 duke u pajtuar me pretendimet e juaja ankimore dhe duke e hequr kriterin e certifikatës ISO 13485 për Lot 1. Me datën 23.03.2023 ju përsëri keni bere Kërkesë për Rishqyrtim duke kërkuar qe kjo certifikate te hiqet edhe për lotët 2 dhe 3.

Edhe përkundër faktit qe u kemi dërguar Vendimin e Rishqyrtimit te datës 21.03.2023, duke marre parasysh rëndësinë e projektit, si Div. i Prokurimit ne MSh kemi kërkuar qe kërkesa juaj e datës 23.03.2023 te shqyrtohet nga përgjegjësit ne IKSHPK dhe konform rekomandimit nga IKSHPK ne pajtohemi me kërkesën tuaj për rishqyrtim te parashtruar te datës 23.03.2023, me ç`rast **Për te gjitha Lot-et hiqet kriteri nr. 6 i Përshtatshmërisë profesionale ne NJK dhe DT (nuk kërkohej certifikata ISO 13485);**

Ne e-prokurim do te behet korrigjimi i kriterit përmes B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. N.T.P ERAMED
2. Operatoreve ekonomik te interesuar



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit